



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 02.07.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit". *(Komision përgjegjës)*
2. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2018 për projektin "Programi sektorial i ujërave/furnizimi me ujë i zonave rurale IV". *(Komision për mendimi)*

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Ardit Konomi, Robert Bitri, Dritan Bici, Arlind Çaçani, Nimet Musaj, Zef Shtjefni, Rrahman Rraja, Kujtim Gjuzi, Ilir Pendavinji dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Gjetan Gjetani dhe Lifter Koka.

Të ftuar:

Artan Shkreli – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Enea Karakaçi - Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Adelina Greca - Drejtoreshë e AKPT-së

Suela Meta - Drejtore në AKPT

Alisa Ramollari - Drejtoreshë juridike në AKPT

Hantin Bonati - Zëvendësministër

Lindita Sotiri - Drejtor

Jovan Gjika - Koordinator i Projektit (AKUM)

Leonard Miloti - Koordinator i Projektit (FSHZH)

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Veprimtarive Prodhuese. Sot kemi në shqyrtim projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. Relatore është zonja Eglantina Gjermeni.

Të ftuar kemi përfaqësues të Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, zotin Artan Shkreli, zëvendësministër, drejtoreshën e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe përfaqësues të tjerë nga Agjencia e Territorit.

Pasi të dëgjojmë prezantimin e relatores, zonjës Gjermeni, do të vijojmë me prezantimin nga përfaqësuesit e ministrisë, pastaj do të vazhdojmë me pyetjet dhe komentet. Mendoj se sot do ta miratojmë në parim, nën për nën dhe në tërësi.

Zonja Gjermeni, fjala për ju.

Eglantina Gjermeni- Faleminderit, kryetar!

Në fakt, ky është një projektligj që vjen për ta kaluar me procedurë të përshpejtuar, i cili lidhet me ndryshimet për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Për këtë projektligj ka disa shtesa dhe ndryshime që vijnë nga qeveria, pikërisht nga zbatimi, problematika apo sfidat që kanë hasur qoftë ministria, qoftë Agjencia për Zhvillimin e Territorit apo Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit.

Shkurtimisht dua të them që do t’i shikojmë ndryshmit një nga një dhe, patjetër, zëvendësministri dhe ekipi i tij do t’i paraqesin në mënyrë të detajuar. Unë do t’i përmend shkurtimisht dhe të jap komentet e mia, në mënyrë që, kur të diskutohen t’i qartësojmë.

Ndryshimi i parë lidhet me Agjencinë e Zhvillimit të Territorit, përkufizimin e saj si një institucion me përgjegjësi në zhvillimin e territorit dhe që kryen funksionet e sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit mendoj se është patjetër e domosdoshme, kjo për faktin se kur ka kaluar ligji i planifikimit të territorit dhe është miratuar në parlament, agjencia nuk ekzistonte, kështu që normalisht duhet një përkufizim i plotë dhe i saktë i saj.

Në nenin 2 kemi një ndryshim, ku sugjerohet nga qeveria që Këshilli Kombëtar i Territorit vendos miratimin e rregulloreve të veçanta për kushtet e zhvillimit, për rastet në kompetencë të saj. Sipas relacionit dhe sipas informacionit që kemi, ndoshta do të na duhet informacion më shumë nga zëvendësministri për kushte specifike të dhënies së lejes nga Këshilli Kombëtar i Territorit. Sigurisht duke qenë një institucion që merr vendime në nivel kombëtar apo planifikon zhvillime në nivel rajonal apo kombëtar, i duhet të ketë një rregullore specifike dhe të përcaktohen në këtë ligj të planifikimit të territorit. Ky është

justifikimi. Pyetja ime është nëse këto duhet patjetër të vendosen në ligj apo mund të miratohen edhe me vendim të Këshillit të Ministrave.

Për sa i përket ndryshimit tjetër, në nenin 3 përcaktohet “Autoriteti përgjegjës për miratimin përfundimtar, jo më vonë se 15 ditë pas botimit në Regjistrin e Planifikimit të Territorit, dërgon pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për regjistrim planet e detajuara për zona të rëndësisë kombëtare, planet e përgjithshme vendore dhe planet e detajuara vendore. Me regjistrimin e dokumenteve të planifikimit ndryshon automatikisht resursi i tokës, sipas parashikimit të planit”. Për këtë nen kam dy pyetje.

Pyetja e parë: ky ndryshim që ju paraqisni a bie në konflikt me ligjin për mbrojtjen e tokës bujqësore?

Pyetja e dytë: çfarë do të bëhet për ligjin për pyjet dhe për ligjin për mbrojtjen e tokës bujqësore?

Mund ta diskutojmë së bashku dhe të biem dakord për këtë, por unë kam një sugjerim, me regjistrimin e dokumenteve të planifikimit nuk ndryshon automatikisht resursi i tokës, sipas parashikimit të planit, sepse plani ka parashikime dhe nuk dihet nëse do të zbatohen 100% ato, prandaj unë sugjeroj që në momentin që të jepet leja e zhvillimit, atëherë të mund të ndryshojë automatikisht resursi i tokës. Kjo është edhe për të ruajtur tokën bujqësore, edhe për të parandaluar çfarëdolloj vendimi tjetër, sepse planet, gjithsesi, janë vizion zhvillimi për vitet e ardhshme, ndërkohë që, kur jepet leja e zhvillimit, aty është e përcaktuar nëse do të tjetërsohet apo jo toka.

Për sa i përket nenit 4, sërish KKT-ja vendos miratimin e rregulloreve të veçanta për kushtet e zhvillimit për rastet në kompetencë të saj. Besoj se kjo është përsëritje, edhe me ndryshimin që keni në fillim, dhe ndoshta këshilltarët e komisionit në bashkëpunim me ministrinë duhet ta shikojnë nëse duhet thënë dy herë në ligj kjo apo jo.

Për sa i përket nenit 5, “Leja e zhvillimit është e nevojshme për çdo parcelë dhe jepet me miratimin e planit të detajuar vendor. Në rastin e parcelave, për të cilat nuk parashikohet hartimi i një plani të detajuar vendor, leja e zhvillimit jepet sipas përcaktimeve në rregulloren e zhvillimit. Autoriteti përgjegjës, jo më vonë se 15 ditë nga miratimi, dërgon pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për regjistrim lejen e zhvillimit. Me regjistrimin e lejes së zhvillimit ndryshon automatikisht resursi i tokës sipas parashikimit të lejes.”. Për këtë kam një pyetje specifike. A janë konsultuar me ministrinë e linjës dhe, në këtë rast, në mënyrë specifike me Ministrinë e Bujqësisë dhe autoritetet vendore ndryshimet që ju paraqisni, për faktin se ky ligj pa dyshim prekë bashkitë dhe punën e tyre, planet vendore e të tjera me radhë?

Për sa u përket planeve vendore, meqenëse në relacion shkruhet se ka disa bashki që nuk i kanë miratuar ende planet e detajuara, por planet e përgjithshme vendore, dua të di, me sa kam dëgjuar ministrin është parashikuar që brenda vitit 2019 ju do t'i miratoni të gjitha nëse janë të gjitha planet e përfunduara brenda këtij viti.

Në nenin 3, i cili ndryshon nenin 25, parashikohen ndryshime resursi të tokës me regjistrimin në kadastër të planeve të detajuara, ndërsa në këtë pikë parashikohet ndryshimi i resurseve me dhënien e lejes së zhvillimit. A ka nevojë që të kemi gjithmonë ndryshim resursi me regjistrimin e lejes, kur kjo do të bëhet me regjistrimin e dokumenteve të planifikimit?

Më falni që për çdo nen kam edhe pyetje, edhe komente, por e bëra këtë për faktin që ta ezauroj dhe ju gjatë përgjigjes suaj të mund t'u jepni përgjigje edhe shqetësimeve apo sugjerimeve të mia.

Në nenin 6 fjalët “autoriteti përgjegjës i planifikimit” zëvendësohen me fjalët “autoriteti përgjegjës i zhvillimit”. Unë jam plotësisht dakord për këtë, kjo edhe për faktin se bëhet fjalë edhe për Agjencinë e Zhvillimit të Territorit.

Sugjerimi tjetër lidhet me afatet për sa i përket sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit, ku bëhet fjalë për ditë pune, e cila është shumë e domosdoshme dhe ka lindur si problem nga praktika.

Në nenin 8, me ndryshimet që ju sillni, ndryshohet neni 48, ku propozohen ndryshime në të gjithë nenin për shtimin e ndryshimit të projektit gjatë ndërtimit. Edhe kjo besoj se është shumë e nevojshme, se përcaktimi që ju bëni “Rishikimi i kushteve të lejes apo ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit” ka dalë nga ecuria e punës dhe e zbatimit të këtij ligji.

Dua të theksoj se pranë komisionit kanë ardhur edhe disa ndryshime nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe besoj se do të kemi kohën e duhur për t'i diskutuar dhe për të rënë dakord edhe ne si komision, edhe ju si përfaqësues të qeverisë për ndryshimet që sjellë AKPT-ja për të komplementuar edhe ndryshime që sjell qeveria apo Agjencia e Zhvillimit të Territorit.

Një pjesë e ndryshimeve të AKPT-së janë të domosdoshme. Ndoshta nuk kemi shumë kohë, por gjithsesi mund t'i diskutojmë bashkë. Dua përgjigje për pyetjet dhe sugjerimet që dhashë.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zonja Gjermani!

Fjalën e ka zoti Shkreli.

Artan Shkreli - Meqenëse këtu flitet për nene konkrete, unë do të relatoj shumë shkurt në parim.

Zonja Gjermani bëri një pasqyrë shumë të mirë nen për nen të propozimeve, të cilat kanë ardhur përmes vendimit të Këshillit të Ministrave, si dhe një propozim shtesë që vjen nga AKPT-ja, i cili është në funksion të së njëjtës frymë të përmirësimit, pra jo të ndryshimit të bazës ligjore, por përmirësime qoftë të nivelit terminologjik, qoftë saktësime të nivelit institucional, qoftë edhe përmirësimit të mënyrës sesi regjistrohet apo edhe kohës së kthimit të përgjigjeve.

Ndryshimet e propozuara synojnë rregullime në ligjin ekzistues nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. Këto rregullime vijnë si rezultat i problematikave të ndryshme që janë ndeshur në praktikë, pra nuk janë të nivelit empirik, por vijnë direkt nga sugjerimet dhe përplasjet që kemi ditë për ditë në këtë proces shumë të vështirë të implementimit të kthimit të planeve rregulluese nga niveli zhvillimor në atë ndërtimor.

Konkretisht, këto ndryshime kanë si objekt shpërndarjen e kompetencave tek autoritetet përkatëse dhe, konkretisht, përcaktimin e mundësisë për të miratuar rregullore të veçanta lidhur me kushtet e zhvillimit nga Këshilli Kombëtar i Territorit, për tipologjitë e zhvillimeve që janë kompetencë të këtij organi; zbatimin e procedurës së ndryshimit të resursit të tokës në zonat, për të cilat ka dokumente planifikimi dhe leje zhvillimi të miratuara nga autoritetet e zhvillimit, si dhe nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës; saktësimin e leja e zhvillimit për rastin e parcelave, për të cilat nuk parashikohet hartimi i një plani të detajuar vendor, në përputhje me përcaktimet e rregullores së zhvillimit dhe regjistrimin pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; saktësimin e afatit ligjor për miratimin e lejeve të ndërtimit në përputhje me përcaktimet e vendosura në Rregulloren e Zhvillimit të Territorit dhe në sistemin “e-leje”, si dhe saktësimin e terminologjisë, pra, emërimit të një kategorie lejeje. Këto janë shtyllat e rregullimeve ligjore që propozohen në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, e ndryshuar.

A mund të vazhdoj me përgjigjet e pyetjeve të zonjës Gjermani, apo të mbledh edhe pyetjet e anëtarëve të tjerë?!

Niko Peleshi- Fillimisht përgjigjuni pyetjeve të zonjës Gjermani, pastaj vazhdojmë me pyetjet e tjera.

Artan Shkreli- Në relatimin e zonjës Gjermani, ku bëri edhe pyetjet, ajo i kaloi të gjitha nenet, kështu që edhe unë do të përgjigjem për të gjitha nenet.

Në nenin 1 dhe nenin 2 nuk kishte problematika. Në nenin 3 thuhet: “Autoriteti përgjegjës për miratimin përfundimtar, jo më vonë se 15 ditë pas botimit në Regjistrin e

Planifikimit të Territorit, dërgon pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për regjistrim planet e detajuara për zona të rëndësishme kombëtare, planet e përgjithshme vendore dhe planet e detajuara vendore. Me regjistrimin e dokumenteve të planifikimit ndryshon automatikisht resursi i tokës, sipas parashikimit të planit”.

Ky është një ndryshim, i cili vjen si rezultat i përplasjeve që shpeshherë kemi. Domethënë, ne kemi miratuar një dokument, që është plani i përgjithshëm rregullues, i cili parashikon që në zona të caktuara, aty ku thuhet: “tokë bujqësore”, parashikon zhvillime të reja dhe në këtë moment bie përcaktimi si tokë bujqësore dhe futet përcaktimi si truall për ndërtim në miratimin e këtij plani, ndërsa në momentin që aplikohet për leje ndërtimi, aplikuesi duhet edhe një herë të shkojë te Ministria e Bujqësisë dhe të kërkojë që kjo tokë, e cila është tokë bujqësore, të kthehet në truall, ku ndonjëherë i vjen përgjigje pozitive, ndonjëherë negative, por pothuajse gjithmonë është negative. Në këtë moment fillon një përplasje institucionale, sepse ai me të drejtë thotë që kam një dokument shtetëror, ku thuhet se mund të ndërtojë dhe, nga ana tjetër, ligji i tokës nuk e ka lejuar Ministrinë e Bujqësisë që tokën e bukës ta bëjë truall për ndërtim.

Ideja e që parashikon ky ndryshim ligjor, që përmendi zonja Gjermani, është që këto toka të kthehen automatikisht. Nga njëra anë nuk duhet të ketë përplasje me ligjin e tokës dhe ky është momenti që ne kemi vendosur ta bëjmë me ligj këtë automaticitet, në mënyrë që ky ligj suprimon ligjin e bonitetit të tokave, ku bëhet fjalë për plane rregulluese, por me të drejtë zonja Gjermani vë re se ka një përplasje midis këtij neni, nenit 3 dhe nenit 5, ku thuhet: “Leja e zhvillimit është e nevojshme për çdo parcelë dhe jepet me....”.

Kërkesa e zonjës Gjermani, e cila thotë se ne nuk kemi pse të kalojmë automatikisht në planin e përgjithshëm rregullues, nga tokë bujqësore, në truall, por sugjeron vetëm kur ka kërkesë për leje ndërtimi. Kjo më duket më e arsyeshme, pasi shmangim konfliktin e taksave, sepse shumë toka bujqësore kanë taksë më të ulët sesa toka truall për ndërtim dhe një pronar që sot e ka tokë bujqësore, por plani rregullues ia parashikon si truall për ndërtim ai nuk ka pse paguan taksa për ndërtim, sepse ai nuk ka ndër mend për momentin që ta zhvillojë tokën për ndërtim. Kështu që ideja e automaticitetit, i kalimit të truallit të tokës nga tokë bujqësore në truall të bëhet në momentin e kërimit të lejes së ndërtimit, më duket më e arsyeshme dhe mendoj që sugjerimi i zonjës Gjermani duhet marrë parasysh, ku shmangim në një masë shumë të madhe edhe këtë konflikt.

Për sa i përket çështjes nëse ka pasur një akordim apo konkordim me Ministrinë e Bujqësisë për nenin 5, dua t’ju them që nuk ka pasur shkëmbim korrespondence midis dy institucioneve, por Ministria e Bujqësisë është shprehur në mbledhjen e Këshillit të

Ministrave dhe ka rënë dakord për këtë amendim. Megjithatë, nëse do të kërkohet, ne do ta plotësojmë dokumentacionin edhe me një shkresë specifike nga Ministria e Bujqësisë.

Për sa i përket nenit 4, ku thuhet se në pikën 1 të nenit 28 të ligjit në fuqi shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “KKT-ja vendos miratimin e rregulloreve të veçanta për kushtet e zhvillimit për rastet në kompetencë të saj”, në fakt, duket sikur është përsëritje, por njëra është në nivel planifikimi, ndërsa tjetra është në nivelin e lejeve zhvillimore. Besoj se duhet t’i specifikojmë të dyja, pra të mos i njësojmë, sepse janë dy kapituj të ndryshëm, që përkojnë edhe me dy faza të ndryshme të procedurës.

Po ia kaloj fjalën zotit Karakaçi.

Enea Karakaçi – Kam një sqarim lidhur me pyetjen për shtesat në nenin 4 dhe nenin 2, pse propozohen me ligj dhe VKM. Aktualisht ligji në fuqi parashikon se këto lloj rregulloresh miratohen me VKM, ku i është nëndeleguar KKT-së një e drejtë nga Këshilli i Ministrave. Në Gjykatën e Apelit ka pasur një proces gjyqësor, e cila është shprehur që nuk mund të ketë një lloj nëndelegimi të tillë dhe, si e tillë, ne kemi vlerësuar që është më mirë dhe më e rregullt, duke e marrë në konsideratë vendimin e gjykatës, që ky propozim të bëhet direkt në ligjin përkatës. Gjithashtu, dua të diskutojmë, meqenëse kemi të bëjmë me 4 nene jo shumë thelbësore, por që e ndihmojnë shumë punën e autoriteteve që merren me planifikimin e territorit, të propozuara nga AKPT-ja. Kam edhe drejtoreshën, me të cilën do t’u përgjigjemi të gjitha pyetjeve që mund të bëhen nga ana e komisionit.

Neni 1, pika 1 ndryshohet si më poshtë: “Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit është institucion përgjegjës për çështje të planifikimit të territorit në nivel kombëtar”. Bëhet fjalë vetëm për ta definuar në nivel ligjor rolin që ka, pra për të legalizuar në nivelin e rregullimit të pikëpamjes terminologjike të përcaktimit të këtij institucioni.

Pika 2 e nenit 2 ndryshohet me këtë përmbajtje: “Nisma për hartimin e planit të detajuar për një zonë të rëndësisë kombëtare merret nga ministri përgjegjës për çështjet përkatëse të rëndësisë kombëtare ose nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, sipas rastit, me kërkesë të autoriteteve publike apo të çdo pale të interesuar”.

Kjo është e domosdoshme, sepse shpesh herë kemi pasur ndalesa...

Niko Peleshi – Më fal, sepse jemi ende në diskutimin në parim, ndërkohë që ju po e diskutoni nen për nen.

Unë ju dhashë fjalën që t’u përgjigjeshit pyetjeve të zonjës Gjermani, por duke i trajtuar në frymën projektligjit. Pra, për detaje dhe formulime të neneve do të diskutojmë më vonë, pasi të mbyllim diskutimin dhe miratimin në parim.

Pra, le të vazhdojmë me pyetje të tjera!

Urdhëroi, Musaj!

Nimet Musaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar përfaqësues të ministrisë,

Kam një koment dhe 3 pyetje të shkurtra, që më pas të kalojmë nën për nën.

Sot ne po përqendrohemi te ky ligj për ndryshimin e resurseve të tokës dhe kjo është shumë e rëndësishme për të gjithë fermerët e qytetarët. Me anë të këtyre amendamenteve parashikohet që ndryshimi automatikisht i kategorive të tokës në momentin e regjistrimit pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, pavarësisht se kjo justifikohet, të bëhet në përputhje me parashikimet e vendosura në dokumentin e planifikimi apo lejen e zhvillimit.

Është i rëndësishëm neni 5 i këtij ligji, pra pika 2 e nenit 38 të ligjit ekzistues, ku thuhet: “Leja e zhvillimit është e nevojshme për çdo parcelë dhe jepet me miratimin e planit të detajuar. Me regjistrimin e lejes së zhvillimit, ndryshon automatikisht resursi i tokës, sipas parashikimit të lejes e të tjera”. Unë dua të them që me ligjin ekzistues zgjatja e procedurave në kohë u ka dhënë mundësi organeve përkatëse për një verifikim më të plotë të situatës lidhur me problematikat e mundshme apo të ndërmarrjes së veprimit juridik.

Kam këto pyetje.

Së pari, pse ky përshpejtim procedurash?

Së dyti, a mund të sjellë përshpejtimi i procedurave abuzime apo dëme të mundshme të pariparueshme?

Së treti, a mund të ketë vend për abuzime, pasi ndryshimi automatikisht i resursit të tokës, sipas amendamentit, mund të na sjellë pasoja të pariparueshme?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Gjuzi!

Më pas fjalën e ka zoti Valteri.

Kujtim Gjuzi – Faleminderit, zoti kryetar!

Nëse më lejoni, kam dy pyetje për zëvendësministrin. Në të gjithë territorin e republikës vëmë re se të gjithë njerëzit i kanë lënë kodrinat dhe po zbresin poshtë në tokën e bukës. Me këtë ndryshim të ligjit që ju kërkoni, a do të ketë një risk të lartë që toka e bukës të shkojë drejt shterimit?

Së dyti, që nga koha kur ju keni ardhur në qeverisje (në fakt, i keni ndaluar diku betonet, sepse kishin betonizuar bregdetin poshtë, dhe shumë mirë keni bërë për atë dhe, personalisht, ju kam përgëzuar), a keni dijeni se edhe tani, që diskutojmë bashkë, vazhdojnë ndërtime të paligjshme në tokat bujqësore apo në tokat e bukës?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Valteri!

Halit Valteri – I nderuar zoti Zëvendësministër,

Kam një pyetje: a ka një numër të saktë sa janë aplikimet e tejzgjatura apo të refuzuara për leje ndërtimi, për shkak se ka qenë tokë bujqësore?

Niko Peleshi – A ka pyetje të tjera? Nuk ka pyetje.

A komente dhe diskutime?

Urdhëroni, zoti Beqaj!

Ilir Beqaj – Mendoj se duhet të bëjmë një vlerësim: do të diskutojmë për projektligjin që ka ardhur nga agjencia e planifikimit? Nga eksperiencia që kam në komision prej vitesh nuk ka ndodhur ndonjëherë që vetë qeveria përveç një versioni të këtë edhe një dokument tjetër, që mund të jetë shumë i mirë në përmbajtje, por si do ta zgjidhim?!

Më pas reflektimi i këtyre të dytave praktikisht do të jetë amendamenti ynë, sepse nuk ka si të jetë tjetër. Ndërkohë që në fillim shikoj se ka një lloj konkurrence institucionale, që është normale, përderisa kemi planifikim dhe zhvillim, sepse në versionin zyrtar neni 6 thotë: fjala “planifikim” bëhet “zhvillim”, kurse në dokumentin tjetër neni 3 thotë: “zhvillimi” bëhet “planifikim”. Këtu kuptohet që institucionet mund të tërheqin nga vetja, por ne duhet të shikojmë të gjithën. Sugjeroj që fillimisht qeveria të na japë nëpërmjet zëvendësministrit sot apo në një tjetër moment një përgjigje shtruese si do të vazhdojmë. Më pas mund t’u hyjmë çështjeve të tjera. Paraprakisht, do të kërkoja ndihmën e zëvendësministrit nisur nga eksperiencia e tij më shumë se 20-vjeçare nëse diku nëpër nene mund të shtojmë edhe një gjë, që unë e kam merak. Ne nuk kemi ndonjë afat, për sa kohë zhvillohet një leje ndërtimi. Në Tiranë ka pallate, që janë ngritur si karabina prej 15 vjetësh. Tani ne nuk mund ta lëmë... Aty mund të ketë probleme pronarësh, çështjesh financiare e të tjera, por në një moment duhet t’i vëmë një tavan dhe, përveç tavanit, të vendosim nëse do t’i marrë shteti duke u kthyer lekët që janë harxhuar apo nëse do t’i shkatërrojmë dhe kush do ta paguajë faturën e shkatërrimit, sepse ka mostra që rrinë vërdallë. Është ai tek “Sheshi i flamurit” që ka 20 vjet dhe nuk i ndodh gjë. Kemi edhe këtu në bllok apo kudo, që mund të jenë edhe me leje.

Mendoj se edhe sot mund të ketë një ndërtim pa leje; mund të jetë dikush që del me armë pa leje, dikush që hyn me semafor të kuq. Domethënë, paligjshmëria është një proces. Edhe sikur të fotografojmë sot, pas një ore mund të fillojë dikush dhe të ndërtojë pa leje.

Niko Peleshi – Urdhëroni, zonja Gjermani!

Eglantina Gjermani – E vlerësoj komentin e kolegut Beqaj.

Ajo që sugjeroj unë si rektore është:

Së pari, ndryshimet e këtij projektligji kanë ardhur me procedurë të përshpejtuar dhe, parimisht, ne kemi për ta diskutuar dhe për ta miratuar në parlament ditën e enjte. Ne jemi komision përgjegjës dhe sugjeroj që pa dyshim të shikojmë variantin që ka ardhur zyrtarisht nga qeveria, si dhe të diskutojmë e të kalojmë në miratimin e ndryshimeve me prioritet, meqenëse është me procedurë të përshpejtuar.

Ndërkohë, unë si relatore kam pasur mundësi të shikoj edhe sugjerimet, që vijnë nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit. Ndryshimet, që kanë ardhur zyrtarisht në komision, nuk janë në konflikt, përkundrazi, janë plotësuese me ndryshimet që sjell qeveria. Madje, besoj se shumë herë janë për sqarime apo detajime të nevojshme, disa herë të domosdoshme nga praktika e planifikimit dhe e zhvillimit të territorit. Kini parasysh se, kur është miratuar ligji i planifikimit të territorit në vitin 2014, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit kishte përgjegjësinë edhe të planifikimit, edhe të zhvillimit të territorit. Më pas me vendim të Këshillit të Ministrave është krijuar Agjencia e Zhvillimit të Territorit.

Në qoftë se vërtet japim një specifike apo një përkufizim të Agjencisë për Zhvillimin e Territorit, atëherë ndryshimet që sjellin qeveria dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit definojnë realisht Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit. Pra, në qoftë se vërtet të gjithë kolegët bien dakord që, pasi të diskutojmë variantin e sjellë nga qeveria dhe t'i miratojmë ato ndryshime, t'i shikojmë edhe sugjerimet e sjella nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, duke i diskutuar dhe duke i miratuar sipas këndvështrimit apo praktikës që kemi secili nga ne meqenëse ky ligj vjen tani për ndryshime, me qëllim që të mos vijë përsëri për ndryshime pas 1 viti apo pas 6 muajsh.

Meqenëse jemi tani, sugjeroj që t'i shikojmë një nga një. Nëse do të biem dakord apo nëse nuk do të biem, sigurisht që kjo varet nga secili prej nesh.

Faleminderit!

Niko Peleshi – A ka ndonjë diskutim tjetër?

Urdhëroni, zoti Beqaj!

Ilir Beqaj – Do të flas për dy gjëra: po e nis nga e fundit, pra ne nuk mund të mbarojmë vetëm me variantin e qeverisë dhe pastaj t'i kthehemi tjetrit, për shembull ne nuk mund ta amendojmë dy herë nenin 3. Duhet t'i marrim një për një, kur të vijë radha te neni 3, do të bëjmë edhe njërin, edhe tjetrin. Po e mbaruam, nuk mund t'i kthehemi nenit 3, sepse është procesi formal i diskutimit të nenit.

Ndërsa lidhur me ardhjen zyrtarisht nga Agjencia, tani të drejtën për iniciativë e kanë ose qeveria, ose deputeti ose 20 mijë zgjedhës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë se ka ardhur!

Niko Peleshi – A ka diskutime të tjera?

Diskutimi i zotit Beqaj qëndron, dhe ne duhet ta regjistrojmë si vërejtje për ministrinë, sepse nuk duhet të krijohet ky precedent. Pra, nuk duhet të kthehet në një precedent. Pa dyshim që ne, duke marrë parasysh edhe procedurën përshpejtuar të këtij projektligji, do ta shqyrtojmë variantin e miratuar në Këshillin e Ministrave dhe do t'i marrim në konsideratë të gjitha propozimet e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit një për një, por nuk do ta kthejmë në praktikë.

Ndaj, le ta fillojmë diskutimin me një vërejtje: herë tjetër në këtë komision ne do të pranojmë një propozim nga ministria, nga qeveria dhe nga institucionet e tjera të qeverisë. Ne mund të mirëpresim këtu, dhe e kemi detyrim ligjor të dëgjojmë grupe interesi, shoqata të caktuara e të tjera, por nuk i dëgjojmë dot të gjitha agjencitë e qeverisë. Pa dyshim që kemi të drejtë t'i thërrasim, por jo të vijmë me propozime të ndryshme.

Tani që të mos e shohim me negativitet, jemi në një rast kur duket se propozimet janë komplementare. Pra, nuk është se konfliktojnë, të paktën, me aq sa i kemi studiuar, njëri-tjetrin dhe nuk e kemi shumë të vështirë t'i shkrijmë. Ndërkohë që po flisnim, Manjola dhe Xhilda bënë një punë dhe, pak a shumë, i kemi shënuar mbi draftin e qeverisë, pra i kemi futur edhe propozimet e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit si nene apo si fraksione të neneve mbi projektligjin bazë të propozuar nga Këshilli i Ministrave.

Kështu që propozoj që, pasi ta miratojmë në parim, do ta diskutojmë nen për nen dhe, aty ku çmohet insertimi i propozimeve të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, do të ndalojmë dhe do të diskutojmë edhe për to.

Qëndrim im i përgjithshëm është ky: ne nuk mund t'i diktojmë 100% zhvillimet në territor vetëm me ligje dhe ndryshime ligjore. Ndryshimet ligjore, kuadri ligjor, ka pjesën e tij, por më pas kanë rol edhe organet ligjzbatuese, monitorimi, vëzhgimi, ushtrimi i ligjit, ndëshkimi i kryetarëve të bashkive që i shkelin vetë planet e përgjithshme vendore, planin kombëtar apo ligjin e planifikimit të zhvillimit të territorit. Kjo vlen edhe për pyetjen e zotit Gjuzi, në mos gabohem, për veprimtarinë e ndërtimeve pa leje.

Ne kemi për detyrë të bëjmë një ligj sa më të konfirmuar, mundësisht edhe me praktikën më të mira dhe me legjislacionin europian. Më pas zbatimi apo shkelja e tij është përgjegjësi e institucioneve dhe e qytetarëve. Në këtë frymë mbase duhet të shikojmë dhe të diskutojmë, kur t'u vijë radha, për një lloj monitorimi të fiksuar në ligj të dokumenteve të planifikimit, pra për planet e detajuara vendore të bashkive, ku nga Agjencia Kombëtare e

Planifikimit të territorit propozohet që të fiksohet në ligj detyrimi i tyre për të marrë një konformitet nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit paraprakisht, sepse eksperiencia e deritanishme, me sa jam informuar, është që shumë bashki, ndonëse ligji është forcuar shumë, e shkelin. Pra, edhe pse dhe plani i përgjithshëm vendor ka forcën e një ligji, ato e shkelin me planet e detajuara vendore.

Për sa i përket konvertimit të tokës, kam pasur mundësinë që të punoj në të dyja institucionet, pra e kam parë edhe nga një kënd, edhe nga këndi tjetër. Konvertimi i tokës nga Ministria e Bujqësisë në truall aktualisht bëhet vetëm pasi është lëshuar leja e ndërtimit. Pra, një tokë pa pasur lejen e ndërtimit nuk mund të konvertohet në truall, ndërkohë Ministria e Bujqësisë nuk mund të refuzojë konvertimin në truall të një toke, ku është lëshuar një leje ndërtimi konform dokumenteve të planifikimit. Pra, në një lloj mënyre është formalitet konvertimi i tokës, por burokracia bën të vetën.

Ashtu siç pyeti edhe zoti Valteri, ka shumë raste të investitorëve, të cilët ngecin në rrjetin e kësaj burokracie dhe për muaj të tërë nuk arrijnë dot të marrin konvertimin. Propozimet në këtë projektligj synojnë ta reduktojnë këtë burokraci. Mbase kur të arrijmë te neni përkatës mund ta shohim. Mund të mos shkojmë te konvertimi automatik në momentin kur miratohet plani i përgjithshëm vendor, por mund ta ndryshojmë dhe ta bëjmë automatik këtë konvertim ose në momentin kur miratohet plani i detajuar vendor ose në momentin kur lëshohet leja e ndërtimit apo leja zhvillimit, sipas rastit. Gjithsesi, kjo është çështje teknike dhe i takon diskutimit nën për nen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka ndonjë diskutim tjetër para se ta hedhim në votimin në parim?

Urdhëroni!

Kujtim Gjuzi – Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryetar dhe ju miq, edhe një herë dua t'ju sjell në vëmendje, faktin që kemi pasur shumë kauza, për shembull, për të mbrojtur digën e liqenit, zoti Shkreli, dhe kemi dalë bashkë, tani çfarë bëhet aty?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjykata e korruptuar na shtypi ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I nderuar zoti kryetar, ne duhet të kemi një gjë parasysh, le ta dinë edhe kolegët që janë në krahun përballë. Unë jam këtu si pasojë e asaj që kam thënë ditën e parë, jam këtu për të ruajtur republikën, parlamentin dhe këtë komision...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, ne jemi këtu për të parandaluar çdo gjë që i bën dëm tokës bujqësore. Atëherë, po i them zonjës, që unë jam ekonomist agrar, prandaj e kam këtë shqetësim.

Faleminderit, zoti kryetar!

Niko Peleshi – Faleminderit!

Atëherë, do ta votojmë në parim projektligjin që na ka sjellë Këshilli i Ministrave...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...ku shtojmë nenin 2/1, që është neni 2 i propozimeve të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, shtojmë nenin 2/2, që është neni 3 në variantin e AKPT-së dhe shtojmë nenin 8/1, që është neni 4 i AKPT-së.

Tani hedhim në votim në parim projektligjin me këto plotësime.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. 1 abstenim.

Zoti Gjuzi abstenoi.

Miratohet.

Kalojmë në diskutimin nen për nen.

Neni 1.

Kanë edhe dy pyetje zoti Valteri dhe zoti Musai, të cilët nuk kanë marrë përgjigje.

Enea Karakaci – Zoti Musai bëri dy pyetje. E para ishte pse ky përsheptim procedurash. Këtu nuk flitet për përsheptim procedurash, por për shkurtimin e kohës teknike për dhënien e përgjigjes dhe kjo është në kuadrin e derregullimit, domethënë janë hequr të gjithë ato elemente, të cilat kanë zgjatur artificialisht kohën e përgjigjes.

Kemi arritur në këtë pikë, sepse ka pasur shumë ankesa për kohëzgjatjen e përgjigjes, madje janë bërë shpesh edhe saktësime, si për shembull, ka qenë 60 ditë, saktësimi tani është bërë 60 ditë pune jokalendarike, pasi ka pasur përplasje. Në kuadër të specifikimeve dhe saktësimeve ka ndodhur ky përsheptim. Pyetja e dytë ishte: a sjell pasoja të pariparueshme çështja e konvertimit të tokës bujqësore në truall. Për sa i përket procesit të planifikimit, nuk sjell pasoja të pariparueshme, sepse, nëse do të marrim parasysh sugjerimin e zonjës Gjermani, ky konvertim do të bëhet në momentin që kërkohet leja e ndërtimit, pra me marrjen e lejes ndodh konvertimi automatik.

Ne e planifikojmë si një tokë që do të konvertohet, por konvertimi ndodh vetëm në momentin e lejes zhvillimore, po të bëhej më përpara mund të sillte pasoja të riparueshme, sepse do të hiqej nga ekonomia bujqësore dhe do të futej në një tokë truall potenciale, por që nuk dihet se kur do të zhvillohet. Kështu që me këtë rregullim që sugjeron komisioni ne e shmangim këtë pariparueshmëri.

Për sa u përket pyetjeve të zotit Gjuzi nëse ka ndërtime të paligjshme në tokat e bukës, dua të them se ky është një proces, i cili nuk ka marrë fund krejtësisht, por është reduktuar në mënyrë drastike. Sot është shumë rrezikshme të bësh ndërtime pa leje, përfshirë tokat e bukës, që janë zona fushore, sepse sot procedon Policia e Shtetit, jo policia e ndërtimit, madje shpesh herë janë bërë edhe arrestime, ku të fundit janë kryer para dy ditësh në zonën e Ksamilit. Prandaj besoj se nuk është ndërprerë plotësisht, kjo është për shkak të formimit të një kulture shumëvjeçare për të ndërtuar pa leje. Natyrisht që ne tentojmë drejt uljes akoma më tepër të këtij fenomeni, i cili ndoshta nuk do të bëhet kurrë zero, por do të jetë në ato përqindje të tolerueshme në një shtet normal.

Sot është realisht frikë të bësh ndërtime pa leje. Për fat të keq (ndoshta për dikë është për fat të mirë) është procedura për legalizimin e ndërtimeve pa leje brenda një kufiri ligjor dhe kohor, të cilët, për një masë të madhe, kanë zbutur ndërtimin pa leje, sepse nga njëra anë njerëzit janë ndaluar të ndërtojnë pa leje, por nga ana tjetër janë lejuar të bëjnë legalizimin e ndërtimeve pa leje, të cilët kanë qenë brenda kufijve ligjorë.

Në lidhje me pyetjen e zotit Valteri se sa janë aplikimet e refuzuara ose të tejzgjatura nga Ministria e Bujqësisë, unë nuk e them dot me shifër, por di të them që është mbi 50%, pra ka qenë shumë e lartë. Tejkaleshmëria e afateve kohore na ka bërë të ndërmarrim këtë rregullim ligjor, për të cilën janë bërë debate edhe në Këshillin e Ministrave.

Për sa i përket sugjerimit të zotit Beqaj nëse mund të shtohet mbarimi i kohës së realizimit të tyre, po i them që ky është një problem që i tejkalon kufijtë e Shqipërisë, pasi është problem edhe në Europën e zhvilluar, madje frika e madhe është për karabinatë që rrinë me dekada. Të gjithë përpiqen ta rregullojnë këtë gjë, por është shumë e vështirë në mënyrë definitive. Duhet marrë patjetër një masë ligjore, ku të kemi të paktën disa afate në rastet ekstreme, pra në rastet ku nuk ka dyshime se çfarë do të ndodhë me objektet që nuk përfundojnë.

Për hir të së vërtetës, objektet në Shqipëri, që mund të kenë 10-15 vjet nuk janë me qindra, por me mijëra, një pjesë e pronarëve të tyre nuk janë më, dikush nuk është fare në Shqipëri, të tjerë janë vrarë, por ka edhe nga ata pronarë aktivë, që nuk kanë interes të zhvillojnë një pronë që e kanë lënë përgjysmë, sepse shpeshherë i kërkojnë qeverisë t'ua shpronësojnë objektin apo t'ia prishin, se nuk kanë më interes ta vazhdojë, edhe pse kanë bërë një investim shumë të madh, sikurse objekti në Vlorë, dhe kjo nuk është më sekret. Qeveria bën bilancet e veta, sepse e sheh që ia vlen të shpronësohet, pasi flitet për objekte me kosto të mëdha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sot ka një përcaktim ligjor, që nuk është definitiv, ku thuhet se brenda 10 vjetësh, nëse objekti nuk mbyllet, duhet të vendosë bashkia, por nuk thotë se si duhet të vendosë, ta prishë apo çfarë.

Vullnet Sinaj – Unë kam një pyetje. Gjatë kohës që bëhen shpronësime kur ka një projekt gjigand me interes publik, toka e bukës shpronësohet me 1 mijë apo 2 mijë lekë të vjetra, kurse toka industriale ka një çmim reference.

Tani, ta bëjmë si bisedë, nëse unë kam marrë një projekt 10-20 mijë metra katrorë dhe e kam çuar në bashkinë përkatëse për një investim (se ne e dimë shumë mirë si janë këta zhonglerët vërdallë) dhe aty do të kalojë rruga e Unazës së Madhe ose e Unazës së Vogël, si do të shpronësohem? Me 1 mijë lekëshin, apo me 10-15 mijë lekëshin të buxheti i shtetit? Si do ta rregullojmë këtë pjesë? Si do të rregullohen me ligj të gjitha këto toka të bukës, me ndërhyrje nga lart apo me ryshfet? Se kemi parë çudira në këtë vend, ku nga tokë bukë është kthyer në tokë industriale.

Enea Kapakaci – Këto nuk rregullohen me këtë ligj, pasi është një ligj tjetër, që rregullon zyrat e regjistrimit të pasurive. Shpronësimet, për efekt publik, bëhen mbi bazën e një regjistri kombëtar, ku e gjithë territori i Shqipërisë është i ndarë në zona kadastrale (diku te 3000 zona). Agjencia e Pronave ka përcaktuar çmimet për secilën nga këto zona dhe ato variojnë në bazë të llojit të tokës, tokë bujqësore, tokë frutore, tokë për ndërtim, tokë industriale, tokë rezidenciale, sikurse dhe objektet që janë mbi to.

Ne nuk mund të bëjmë një rregullim ligjor mbi atë, sepse flitet për një ligj tjetër, por nëse ai ligj nuk është i përshtatshëm, jam dakord që të ndërmerret një iniciativë parlamentare, qoftë dhe nga ju personalisht, për ta riparë. Por di të them që kur bëhet një shpronësim për efekt publik, vlera e shpronësimit përcaktohet nga denominimi që ka toka në atë moment, pra nuk është se aty ku do të kalojë rruga shndërrohet nga tokë-truall në tokë industriale, pastaj kalon rruga. Nuk ndodh një gjë e tillë. Nëse ka sekserë të shkathët, të cilët kanë informacion më përpara dhe arrijnë të bëjnë transaksione me mijëra hektarë tokë, kjo do të thotë se ata do të shpërblehen nga fati dhe këtë nuk e shmang dot. Por kjo nuk ka të bëjë me ligjin, se mund të ndodhë kudo, kushdo mund të ketë një informacion më përpara...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me këtë dua ta mbyll këtë diskutim. Tani po diskutohet për bajpas-in e Tiranës, i cili kalon matanë kodrave, fillon në Kashar, vazhdon në Baldushk dhe del në Mullet. Që në këtë moment ekziston gjurma. Ju personalisht mund të shkoni t'i blini ato toka dhe, nëpërmjet miqve, t'i shndërroni në truall industrial.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk e di si shndërrohet, se nuk e kam idenë e kësaj teknologjie.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shoqëritë imobiliare në botë me këtë merren, domethënë ky është një biznes tjetër dhe ka riskun e madh të ndryshimit të gjurmës së rrugëve. Deri në minutën e fundit gjurmët e rrugëve ndryshojnë. Gjurma e parë është fizibiliteti, e dyta është projektideja dhe e treta projekti i detajuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Absolutisht, siç u ndryshua bajpasi i Vlorës në sekondën e fundit, sepse dolën në një tokë që nuk ka atë karakteristikë që kërkohej dhe ngelën hektarët në dorë, duke paguar taksën që thotë zoti Beqaj.

Niko Peleshi – Faleminderit për përgjigjet!

A keni gjë tjetër për të shtuar? Nuk keni.

Kalojmë në diskutimin nen për nen.

Neni 1 thotë: “Pas pikës 1 të nenit 3 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje: “Agjencia e Zhvillimit të Territorit është një institucion që ka përgjegjësi zhvillimin e territorit dhe kryen funksionet e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit”. Ndërkohë në ndryshimet e propozuara nga AKPT-ja është dhe neni 1 ku thuhet se AKPT-ja është institucioni përgjegjës për çështjet e planifikimit të territorit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Shkreli, çfarë mendimi keni?

Artan Shkreli – Ky është një rregullim që nuk bën gjë tjetër veçse sanksionon atë çka është në realitet, thjesht përcaktohet më mirë në ligj, qoftë për AZHT-në, qoftë për AKPT-në. Ligji nuk i ka këto terma, sepse është bërë përpara formimit të këtyre agjencive. Domethënë është e domosdoshme.

Niko Peleshi – Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Propozimi e ndryshon AKPT-në, por unë nuk e mbështes daljen nga kuadri i ministrisë përgjegjëse, se AKPT-ja në ligjin bazë është brenda kuadrit të ministrisë përgjegjëse dhe kur del VKM-ja e fushave të përgjegjësisë të çdo ministrie, ikën ministria përgjegjëse. Për veten time nuk jam dakord me shtesën, megjithatë do ta shpreh me votë, kur të vijë momenti.

Niko Peleshi – Një sekondë se u bëmë lëmsh, ne kemi një variant të Këshillit të Ministrave, të cilin do ta hedhim në votë nen për nen dhe sipas rregullores ne hedhim fillimisht në votë ndryshimet, që propozohen këtu, kështu që, duke u njohur me ndryshimet që propozon AKPT-ja, nëse dikush nga ju, si anëtarë të komisionit (se vetëm ju keni të drejtë

t'i propozoni) i propozon, atëherë ne i hedhim në votë, por nëse nuk i propozon askush, nuk i hedhim dot në votë.

Ilir Beqaj – Kjo është çështje juridike, se duhet të bëhet si amendament i yni, përndryshe...

Niko Peleshi - A ka ndokush që do të propozojë ndonjë ndryshim në nenin 1 referuar edhe ndryshimeve që kanë ardhur nga AKT-ja, apo shtesë?

Nëse nuk ka do ta hedhim në votim sipas VKM-së. Apo jo, zonja Gjermani?

Eglantina Gjermani – Unë thjesht sugjeroj të shohim variantin që vjen nga qeveria.

Niko Peleshi – A ka ndonjë propozim alternativ ose plotësues?

Nuk ka.

Atëherë e hedhim në votë nenin 1 sipas variantit të Këshillit të Ministrave.

Neni 1 “Pas pikës 1 të nenit 3 shtohet pikë 1/1 me këtë përmbajtje: “Agjencia e Zhvillimit të Territorit është një institucion që ka përgjegjësi zhvillimin e territorit dhe kryen funksionet e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit”.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në nenin 2.

A ka ndonjë diskutim për këtë nen, referuar edhe propozimeve të AKPT-së? Nuk ka.

Atëherë e hedhim në votë nenin 2 sipas variantit të KM.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. 1 abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në nenin 3.

Keni përpara variantin e Këshillit të Ministrave.

Kush do të diskutojë?

Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Kam një pyetje. Versioni i sjellë nga qeveria është: “Autoriteti përgjegjës për miratimin përfundimtar jo më vonë se 15 ditë pas botimit në regjistrin e planifikimit të territorit, dërgon pranë Agjencisë...”. Me regjistrimin e dokumenteve planifikimi ndryshon automatikisht resursi i tokës. Pse duhet kjo fjalia e fundit e paragrafit? Kjo është më shumë si koment ligji, ose një udhëzues se si punonjësi ta zbatojë ligjin. Çfarë do të thotë “ndryshon automatikisht”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Zoti Beqaj, a mund të jap një interpretim pastaj e plotëson zoti Shkreli? Deri tani, përveç miratimit të planit dhe lejes së ndërtimit duhet edhe një konfirmim

nga Ministria e Bujqësisë për konvertimin e tokës nga arë në truall. Me këtë ndryshim kjo bëhet automatikisht, pra nuk është e nevojshme të merret konfirmimin nga Ministria e Bujqësisë. Apo jo, zoti Shkreli?

(Mungesë incizimi)

Më falni!

Kam një ndërhyrje. Ne mund ta miratojmë siç është, por ka ligje të tjera siç janë “Për tokën”, “Për pyjet” të cilët kanë referime që duhet të rregullohen, sepse aty flitet për të drejtën e Ministrisë së Bujqësisë që të shprehet në rastin e një sipërfaqeje të caktuar e të tjera. Ne e bëjmë këtu automatike, por duhet të ndryshohet edhe atje. Pra, nëse do ta miratojmë siç është, në raport të thuhet: “Të njoftohet Ministria e Bujqësisë dhe institucionet e tjera relevante për ndryshimet që duhet të iniciojnë në ligjet përkatëse”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sot është kështu, duhet ta japë ministria, por kjo e fundit e vonon.

Vullnet Sinaj - Ministria sot bën vlerësimin e asaj tokës, çfarë kategorie është, ta jep ose jo dhe e lë lejen e ndërtimit pezull, kurse në rastin për të cilin po bëjmë ndryshimin, biznesit apo atij që e kërkon lejen e ndërtimit, ne i vijmë në ndihmë, sepse i themi: “Ti e ke marrë lejen e ndërtimit, Ministria e Bujqësisë do ta japë ”Ok” për këtë gjë, vetëm që do të bëhet regjistrimi”.

Niko Peleshi - Sot kështu është.

Vullnet Sinaj - Kam pas një rastin tim dhe kam pritur 2 vjet për ta marrë atë.

Niko Peleshi - A kemi përfaqësues nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit? Më korrektoni nëse e them gabim. Sot është kështu, duhet patjetër të marrësh lejen e ndërtimit, që të bëhet konvertimi i tokës nga Ministria e Bujqësisë, por edhe pasi ke marrë lejen e ndërtimit, ky konvertim bëhet me propozimin e ministrisë dhe me vendim të Këshillit të Ministrave.

Nuk është kështu siç thotë zoti Sinaj, që ministria mund të thotë edhe po, edhe jo, ta miraton kategorinë ose jo, nëse ka lejen e ndërtimit ligjërisht është i detyruar, por praktikisht procedura është e gjatë, sepse kalon nga ministria, nga Këshilli i Ministrave e të tjera. Ajo që propozohet është që këtë procedurë, e cila në një farë mënyre është me detyrim, përcaktim ne e këpusim, sepse është thjesht një burokraci, nuk është as filtër, asgjë, por një kalvar, i cili kërkon kohën e tij për t’u përshkuar, apo jo, kështu është?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duke qenë se është kështu, unë propozoj që diskutimi duhet të jetë: do ta bëjmë automatik që në momentin e miratimit të planit rregullues, planit të përgjithshëm vendor? Do

ta bëjmë automatik në momentin e miratimit të planit të detajuar vendor? Apo do ta bëjmë automatik pasi është dhënë leja e ndërtimit? Në variantin e qeverisë thuhet se bëhet automatik në momentin kur regjistrohet një dokument planifikimi, përfshirë edhe planin e përgjithshëm vendor. Nëse në planin e përgjithshëm vendor, që është plani rregullues me terminologjinë e vjetër është parashikuar që një sipërfaqe toke bujqësore do të konvertohet, për shembull në truall për ndërtime industriale, automatikisht lind e drejta e regjistrimit si tokë bujqësore, e ndryshimit të zërit kadastral në kadastër nga tokë are në tokë truall. Kështu është propozimi juaj?

Adelina Greca – Po, ne sugjerojmë që të bëhet vetëm me PDV-të, pra me rastin e planeve të detajuara vendore dhe lejeve të zhvillimit.

Niko Peleshi - Kush ne? Agjencia? Jo varianti i Këshillit të Ministrave, pasi ky i fundit e ka me plan të përgjithshëm vendor.

Adelina Greca - Agjencia e Zhvillimit të Territorit. Ne mendojmë se do të ishte më e duhura nëse është plani i detajuar vendor dhe leja e zhvillimit, të konvertohen.

Arben Pëllumbi - Njëra ose tjetra.

Adelina Greca - Të dyja, sepse ka raste për të cilat miratohet plani i përgjithshëm vendor të vendosë që për një zonë të caktuar duhet të miratohet një plan i detajuar vendor. Rregullorja e zhvillimit përcakton se në rastin kur ke një plan të detajuar vendor aplikuesi nuk ka nevojë të aplikojë për leje zhvillimi, por shkon direkt për leje ndërtimi. Ne mendojmë se duhet të jetë për të dyja rastet, edhe në rastet e PDV-së dhe në rastet e lejes së zhvillimit.

Niko Peleshi – Leja e zhvillimit jepet në rastet kur nuk ka PDV.

Adelina Greca - Kur ka një plan të përgjithshëm vendor, por nuk kërkohet PDV sipas planit. Aplikohet një herë për leje zhvillimi, kjo është e detyrueshme, para marrjes së lejes së ndërtimit.

Niko Peleshi – Pse të mos e bëjmë jo në momentin kur miratohet PDV-ja, por në momentin kur jepet leja e ndërtimit, se atëherë bëhet konvertimi automatik.

Artan Shkreli - Ky variant është më racional edhe për një shpjegim që mund të na japë vetëm me dy fjalë zonja Greca, sepse kemi edhe disa zona mikse.

Adelina Greca - Planet e përgjithshme vendore përcaktojnë përdorimin e tokës sipas kategorive. Ka edhe kategori ku lejohet bujqësi- banim. Njësitë strukturore e kanë të lejuara një përqindje të caktuar të tokës për t'u përdorur për bujqësinë dhe një pjesë për banim, por kjo në nivelin e planit të përgjithshëm vendor nuk është e specifikuar se cila parcelë do të përdoret për bujqësi dhe cila për banim.

Këto specifikime bëhen në momentin e lejes së zhvillimit. Pra, kthimi automatikisht i resursit në një resurs tjetër do të sillte një lloj konfuzioni, sidomos në raste të kësaj natyre. Kadastra nuk do të dinte sesi ta regjistronte në rastin e dy përdorimeve, ku një përdorim është bujqësia dhe tjetri është banimi. Mora një rast më të thjeshtë për t'u kuptuar, sepse ky propozim sjell dhe vështirësi praktike.

Niko Peleshi - Ju thoni se do të ishte më korrekte që konvertimi automatik të bëhet në momentin e marrjes së lejes së zhvillimit apo të lejes së ndërtimit sipas rastit? Kur kemi PDV nuk ka leje zhvillimi.

Ka nevojë për ndonjë shpjegim për anëtarët e tjerë? Ka pyetje për ta kuptuar më mirë? Kemi propozimin, nëse doni mund ta regjistrojmë në emrin tim, për ta ndryshuar nenin 3, si më poshtë: “Pas pikës 4 të nenit 25 shtohet, pika 4/1 me këtë përmbajtje: “Autoriteti përgjegjës për miratimin përfundimtar jo më vonë se 15 ditë pas botimit në regjistrin për planifikimin e territorit dërgon pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për regjistrim planet e detajuara për zonat e rëndësishme kombëtare, planet e përgjithshme vendore dhe planet e detajuara vendore”. “Me regjistrimin e dokumenteve të planifikimit ndryshon automatikisht resursi i tokës sipas parashikimit të planit” thuhet në versionin e Këshillit të Ministrave”, ndërkohë që propozimi është: “Me lëshimin e lejes së zhvillimit ose lejes së ndërtimit sipas rastit ndryshon automatikisht resursi i tokës”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë dy koncepte të ndryshme.

Më falni!

Që ta sqarojmë pak.

Zoti Shkreli, a ka mundësi të vazhdojmë!

Leje zhvillimore jepet edhe aty ku ka plan rregullues, por nuk është zonë PDV-je? Pra, duhet t'i vendosim të dyja sipas rastit. “Ndryshimi kryhet ose kur lëshohet leja zhvillimore ose leja e ndërtimit sipas rastit”. Në momentin e lejes dhe jo në momentin e regjistrimit të dokumentit të planifikimit. Atëherë, ky është propozimi.

Artan Shkreli - Ky term është i saktë edhe për faktin se ndonjëherë ka leje zhvillimore edhe aty ku nuk ka fare planifikim, në rastin KKT-së. Pra, kjo e përfshin edhe atë rast.

Niko Peleshi - Kam përshtypjen se është neni 5 që flet për atë rast, kur nuk ka fare plan. Kush është dakord me nenin 3 të ndryshuar siç e formulua? Thelbi është që nuk ndryshon në momentin e miratimit, regjistrimit të planit, por vetëm pasi lëshohet leja e zhvillimit ose leja e ndërtimit sipas rastit. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet varianti i ndryshuar.

Neni 4. Në fund të pikës 1 të nenit 28 të shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “KKT-ja vendos miratimin e rregulloreve të veçanta për kushtet e zhvillimit për rastet në kompetencë të saj”. A ka diskutime? Kush është dakord sipas këtij formulimi, variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Zoti Gjuzi abstenon.

Miratohet.

Neni 5 i referohet nenit 38, pikës 2 dhe ndryshon si më poshtë: “Leja e zhvillimit ndryshon për çdo parcelë dhe jepet me miratimin e planit të detajuar vendor në rastet e parcelave për të cilat nuk parashikohet hartimi i planit të detajuar vendor. Leja e zhvillimit jepet sipas përcaktimeve në rregulloren e zhvillimit. Autoriteti përgjegjës jo më vonë se 15 ditë nga miratimi dërgon pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për regjistrim lejen e zhvillimit. Me regjistrimin e lejes së zhvillimit ndryshon automatikisht resursi i tokës sipas parashikimit të lejes”.

Pra, këtu bëhet fjalë për ato raste kur nuk ka dokument planifikimi, por ndërkohë është një rregullore tjetër që rregullon zhvillimet në territor edhe në rastet kur nuk ka dokument planifikimi. Në ato raste domosdoshmërisht lëshohet leja e zhvillimit përpara lejes së ndërtimit. Këtu thuhet se në momentin e lëshimit të lejes së zhvillimit resursi i tokës ndryshon automatikisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Meqenëse e pranuar si term ose nocion të neni 3, nuk ka kuptim ta ndryshojmë të neni 5. Le të vazhdojmë me këtë terminologji.

Eglantina Gjermani - Meqenëse edhe të neni që sapo kaluar themë: “Me lëshimin e lejes”, këtu thuhet: “Me regjistrimin e lejes”, duhet të përdorim të njëjtin term për të dyja rastet.

Niko Peleshi - Në të dyja rastet do të përdoret termi “regjistrim”. Unë bëra një formulim të momentit, ndërkohë këshilltarët e komisionit do ta përshtatin atë.

Kush është dakord me nenin 5 siç është, pra me variantin e Këshillit të Ministrave?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtu është, të neni 3 do ta ndryshojmë.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6. Në pikën 1 të nenit 42 fjalët: “Autoritetet përgjegjëse të planifikimit” zëvendësohen me fjalët: “Autoriteti përgjegjës i zhvillimit”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Në nenin 7 thuhet: “Në pikën 2 të nenit 44 pas fjalëve: “Brenda 60 ditëve”, shtohet fjala : “Pune”. Kush është dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është kalendarike, bëhet ditë pune. Ky është propozimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Shkreli – Të gjitha dokumentet e zhvillimit janë me ditë pune, vetëm kjo ka mbetur pa specifikim. Këtu është e gjithë çështja. Këtu flitet për ta homologuar këtë gjë me të gjitha përcaktimet e tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi - E dëgjuam argumentin e qeverisë, edhe të zotit Beqaj. Jemi të detyruar ta hedhim në votim propozimin e zotit Beqaj. Kush është dakord, që në nenin 7, pika 2 e nenit 44 pas fjalëve “brenda 60 ditëve” të shtohet fjala “kalendarike”. Kundër?

Ilir Beqaj - Po të jetë “ditë pune”, i bie 12 javë, më duket shumë.

Niko Peleshi – Propozimi është i qartë, votimi është në dorën tuaj. Varianti i qeverisë është “ditë pune”, propozimi i zotit Beqaj është “ditë kalendarike”. Teknicieni, zoti Shkreli thotë (më falni që po e “përkthej”) : “E kemi të nevojshme, sepse shpesh herë bien festa në mes dhe 60 ditë janë shumë pak”. Përderisa e kanë sjellë si propozim, do të thotë se iu ka dalë si problem.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Pëllumbi ka diçka.

Arben Pëllumbi – Për të qenë të qartë, sot e kemi 60 ditë, pra dy muaj, ndërsa varianti që propozon qeveria është që ta çojmë në tre muaj. Zoti Beqaj thotë që ta lëmë dy muaj e gjysmë, pak a shumë. Për këtë po flasim.

Edhe përfaqësuesja e AZHT-së do të diçka.

Pastaj zonja Gjermani.

Alisa Ramollari – Faleminderit!

Unë doja të bëja vetëm një saktësim. Në rregulloren e zhvillimit të territorit, që është miratuar me VKM, të gjitha afatet janë në ditë pune. Procedurat që kryhen, si nga bashkitë, si nga AZHT-ja, janë në ditë pune. Kjo është bërë thjesht për të harmonizuar ligjin me VKM-në dhe sistemin e-leje.

Ky nen i referohet miratimit në heshtje. Nuk do të thotë automatikisht e afati shkon 60 ditë pune. Miratimi i një leje mund të bëhet edhe për 45 ditë. Ky është afati maksimal. Kur bashkia nuk vepron, leja e ndërtimit miratohet në heshtje brenda 60 ditëve.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Faleminderit!

E para, besoj se një ligj është mbi çdo lloj VKM-je. E dyta, nëse duam të jemi homogjenë me ditët e punës, në qoftë se nuk është kungulleshkë 45-a, i del 47, 7, le të themi 48.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, kryetar!

Unë nuk besoj se ka një lëvizje shumë të madhe ditësh. Bëhet fjalë për dhjetë ditë, maksimumi pesëmbëdhjetë ditë. Ndërkohë, me e-lejet priten mendime nga të gjitha institucionet, që të koordinohet puna dhe të jepet leja në përputhje me ligjin dhe të gjitha mendimet që vijnë nga institucionet përgjegjëse. Në qoftë, se sipas ligjit, miratimi në heshtje bëhet brenda këtij afati, mund të ketë penalitete dhe mund të ketë miratim në heshtje të lejeve që vërtetë mund të jenë shumë problematike. Kjo thjesht për faktin e nuk janë respektuar afatet. Kësisoj, kërkoj mbështetjen tuaj, për të votuar sipas variantit të qeverisë.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Dakord!

Është e qartë. Hedhim në votë propozimin e zotit Beqaj. I qëndroni idesë për 60 ditë kalendarike apo 48 ditë pune?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

45 ditë.

Atëherë, kush është dakord me propozimin e zotit Beqaj, i cili është si më poshtë: në pikën 2 të nenit 44, pas fjalëve ‘brenda 60 ditëve’ ndryshohet dhe bëhet: ‘brenda 45 ditë pune’.

Kush është dakord?

Numërojini pak, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kundër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, të lutem, se jemi në votim!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Abstenim? Një abstenim. Si është rezultati?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë fiton propozimi i zotit Beqaj. Bëhet: “brenda 45 ditë pune”.

Kalojmë te neni 8.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është dakord me nenin 8, sipas variantit të Këshillit të Ministrave.

Kush është dakord me nenin 8?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është dakord? Kundër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 8.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kundër? 1 kundër, zoti Gjuzi. Abstenim s’ka.

Miratohet neni 8, sipas variantit të Këshillit të Ministrave!

Neni 9: “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”.

Kush është dakord? Kundër? S’ka kundër. Abstenim? S’ka abstenim.

Miratohet!

Kush është dakord në tërësi për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar? Kush është dakord në tërësi?

Artan Shkreli – E kaluam me shumë lehtësi, si gjë jo shumë të rëndësishme. Megjithatë, pasojat do t’i dëgjoni.

Niko Peleshi – Kundër? Abstenim 1.

Miratohet!

Shumë faleminderit!

Do të njoftojmë për shumë pak mbledhjen tjetër të komisionit.

Sot, një mbledhje tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Shkreli – Këto quhen vendime stakonoviste. Stakonovi vendoste: kaq thotë partia.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – E mbyllim mbledhjen e parë të Komisionit të Veprimtarive Prodhuese. Ndërkohë, siç është njoftuar, sot kemi edhe një mbledhje tjetër të komisionit në lidhje me diskutimin, miratimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të

Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2018 për projektin “Programi sektorial i ujërave/furnizimi me ujë i zonave rurale IV”

Do ta diskutojmë sot, në mbledhjen tjetër, pas një pushimi të shkurtër.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 02.07.2019, ora 14:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2018 për projektin “Programi sektorial i ujërave/furnizimi me ujë i zonave rurale IV”. *(Komision për dhënie mendimi)*

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Ardit Konomi, Robert Bitri, Dritan Bici, Arlind Çaçani, Nimet Musaj, Zef Shtjefni, Rrahman Rraja, Kujtim Gjuzi, Ilir Pendavinji dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Gjetan Gjetani dhe Lefter Koka.

Të ftuar:

Artan Shkreli – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Enea Karakaçi- Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Hantin Bonati - Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Lindita Sotiri- Drejtor MEI

Jovan Gjika - Koordinator i Projektit (AKUM)

Leonard Miloti- Koordinator i Projektit (FSHZH)

Niko Peleshi – Hapet mbledhja e Komisionit të Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit.

Në këtë mbledhje kemi në diskutim për miratim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2018 për projektin “Programi sektorial i ujërave/furnizimi me ujë i zonave rurale IV”

Relator është zoti Arben Pëllumbi.

Pa humbur kohë, le të fillojmë me një prezantim të shkurtër nga ana e zotit Pëllumbi. Më pas, përfaqësuesit e ministrisë, zëvendësministri Shkreli, zonja Lindita Sotiri, zoti Jovan Gjika dhe zoti Leonard Miloti, do të jenë të gatshëm për t’iu përgjigjur pyetjeve.

Faleminderit!

Fjalë për ju, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, kryetar!

Meqenëse jemi në periudhën kur bëhen tridhjetë vjet nga bashkëpunimi që kemi me qeverinë gjermane, do të doja të falënderoja për ndihmën që na ka dhënë, kjo edhe për faktin e shuma që na ka akorduar i ka kaluar 1 miliard euro.

Në këtë projektligj që na vjen përpara, bëhet fjalë për fazën e katërt të një projekti, i cili investon në një sektor problematik, siç është furnizimi me ujë higjienikisht të pastër dhe për shërbimet e kanalizimeve.

Ka pasur një garë të hapur, ku kanë aplikuar me projekte qyteti i Himarës dhe zona të tjera të Shqipërisë, po për mungesë fondesh kjo nuk u bë e mundur. Sigurisht, akomodohen tashti në këtë fazë të katërt të projektit, i cili përfshin një kredi me terma të buta, por që do të përcaktohet me firmosjen e kësaj marrëveshjeje edhe një grant prej 2 milionë eurosh, për një kredi prej 40 milionë eurosh, të cilat do të shërbejnë si për qytetin e Himarës dhe një pjesë të fshatrave rreth e rrotull, e po ashtu edhe për zonën e Orikut, sa i takon furnizimit me ujë higjienikisht të pastër dhe sistemeve të kanalizimit, duke pasur parasysh se në zonën e Orikut që është faza përfundimtare e përmbyllëse e të gjithë impiantit të trajtimit të ujërave të zeza.

Kjo është një marrëveshje e lidhur midis dy qeverive, qeverisë shqiptare dhe qeverisë gjermane, dhe financohet nga Banka KfW.

Do të doja të theksoja faktin se bëhet fjalë si për bashkinë e Himarës, ashtu edhe për fshatrat Kuç, Buronjë, Pilur, Kudhëz, Vuno, Jalë, Livadhja, Himarë-fshat, Qeparo dhe Borsh. Kjo është bërë me qëllim, si dhe një zonë që vjen rrotull qytetit të Orikut...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Livadhi, po.

Kini parasysh e është një nga zonat, e cila jo vetëm ka një numër të caktuar banorësh, që llogaritet të jenë rreth 20 mijë, por është një zonë që pritet të sjellë zhvillim të madh të turizmit, duke akomoduar një numër përmbi 80 mijë banorë ekzistues, turistë që vijnë gjatë periudhës së verës, por duke pasur parasysh edhe perspektivat e zhvillimit deri në vitin 2025.

Për këto arsye, unë ju ftoj të gjithëve, që ta miratojmë këtë marrëveshje, duke e mbyllur me një falënderim për qeverinë gjermane.

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Pëllumbi!

Zoti Gjuzi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëro!

(Ndërprerje e shkurtër incizimi)

Ka diskutim tjetër? Një pyetje nga zoti Beqaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Gjuzi, të lutem!

Ilir Beqaj – Nisur nga relacioni, kam diçka, thjesht për plotësim: në Orikum, ekziston impianti dhe duhet vënë në punë, apo duhet bërë nga e para?

Leonard Miloti – Impianti është ndërtuar me fondet e Bankës Islamike dhe do të vihet në punë. Ka përfunduar në 2015-ën. Do të financohet vënia në punë e implantit dhe do të bëhen disa ndërhyrje në rrjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për ta vënë në punë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, s'është vënë në punë, sepse nuk është lidhur me rrjetin dhe nuk është bërë pjesa e shkarkimit në det.

Artan Shkreli – Në njëfarë mënyre është i ngjashëm me impiantin e Vlorës, i cili është i bërë dhe nuk është vënë në punë. Për ta vënë në punë, meqenëse u bënë disa vjet, kërkohej edhe punime mirëmbajtjeje, të cilat janë shumë të thella, për hir të së vërtetës.

(Ndërprerje e shkurtër incizimi)

Për shembull, sa për të bërë një paralele, në lungomaren e Vlorës, meqenëse jam marrë me të, ishte kanalizimi magjistrat i ujërave të zeza. Një pjesë e ujërave të zeza derdhen prapë, sepse financimi kishte si gjë kryesore magjistralin, por jo lidhjen e magjistralit kryesor me... Domethënë, shpeshherë ka pasur edhe inkonvenienca të tilla.

Besnik Baraj – Një pyetje.

Niko Peleshi – Po.

Besnik Baraj – Kjo që thatë ju është e vërtetë, është një konstatim. Pra, është bërë impianti. Mund të ketë edhe zona të tjera, janë dhjetëra milionë euro të investuara, po ndërkaq do të donim të dinim e si do të jetë perspektiva e kësaj gjëje. Sepse, sa do që të kushtojë ajo, krahasuar me cilësinë e mjedisit, krahasuar me impaktin që ka në psikologjinë e turistëve vendës e të huaj, humbja që kemi është shumë më e madhe, përfshi imazhin e të tjera.

Artan Shkreli – Unë do të jap vetëm një përgjigje në parim, që është përgjigje e saktë, por jo në detaje. Do të doja të ishte zoti Bonati për të folur në lidhje me detajet, por në këto momente ai është në mbledhjen e sigurisë kombëtare në Ministrinë e Jashtme.

Në parim, ne si ministri kemi kërkuar të bëjmë një census të të gjithë impianteve që nuk janë vënë në punë, shoqëruar me preventiva përkatëse e me vlerat në tri fasha, se çfarë do të thotë vënia në punë e këtyre. Ashtu siç kemi vepruar me rrugët, që pavarësisht se janë konsideruar të përfunduara kanë mbetur mangët për efekt bajpasesh, për efekt lidhjesh me unazat e qyteteve, të njëjtën gjë duam të bëjmë tani me impiantet e pastrimit të ujërave të zeza.

Nuk jam në gjendje të jap shpjegime specifike se si janë ndarë këto tri fasha, por kjo punë do të mbarojë shumë shpejt në ministrinë tonë, dhe meqenëse ka interes, do t'jua vëmë edhe juve në dispozicion, bashkë me vlerat financiare.

Besnik Baraj – Unë thjesht dua të bëj një koment në lidhje me këtë. Është e vërtetë se ne kemi bërë shumë marrëveshje, koncesione, partneritete publike private, dhe nga pikëpamja vizuale ose sipas psikologjisë së njerëzve, ndërtimi i një rruge ka një rëndësi shumë të madhe. Por trajtimin e ujërave të zeza dhe funksionimin e tyre, unë e quaj shumë më shumë të rëndësishme se sa bërjen e një rruge me dhjetë, njëzet ose shtatëdhjetë milionë euro. Arsyeja është se kjo, në radhë të parë ka të bëjë me shëndetin e njerëzve që vijnë aty, ka vlerë ekonomike, sepse lidhet me turizmin e të tjera. Kështu që, në këtë drejtim, ju si pjesë e qeverisë, por edhe ne si pjesë e parlamentit, duhet të sensibilizojmë maksimalisht qeverinë, që këtë ta shikojë me një prioritet të jashtëzakonshëm.

Niko Peleshi – Po, zoti Shkreli.

Artan Shkreli – Është absolutisht e saktë.

Ju jeni një njeri që jeni marrë me problemet mjedisore, gjë që ju jep përparësi edhe në lidhje me një vizion të përgjithshëm që ka qenë në Shqipëri, kur rrugët kanë pasur prioritet në raport me impiantet e pastrimit të ujërave të zeza. Edhe nga sondazhet ë vijnë nga diskutimet me të huajt, del se është më mirë të kemi rrugë më të këqija, por plazh e det më të pastër, e po

ashtu edhe ambiente më të pastra nga pikëpamja higjienike, gjë që i ka mbajtur larg jo të huajt, por familjet. Ata me familje kanë shumë drojë të vijnë në Shqipëri me fëmijë të vegjël e të tjera, pikërisht prej kësaj gjëje.

Ka një ndryshim trendi edhe në politikat qeverisëse, për sa i përket kësaj pune. Për njëzetvjeçarin e ardhshëm, për dy dekadat e ardhshme, parashikohet të investohen 5 miliardë euro, prej të cilave 4 miliardë në fushën e kanalizimeve dhe impianteve të ujërave të zeza, dhe 1 miliard në fushën e ujësjellësit.

Këto janë shifra të paimagjinuara më parë, në lidhje me këtë gjë, e kjo pikërisht sepse është bërë prioritet, i cili nuk mund të neglizhohet më. Tashmë ne po përplasemi me fluksin turistik, me një krizë në këtë pikëpamje, le të themi, krizë e cila do të jetë e vështirë të trajtohet nëse nuk veprojmë menjëherë.

Niko Peleshi – Faleminderit!

Zoti Beqaj ka një ndërhyrje.

Ilir Beqaj – Jo, kam pyetje.

Në rastin e Himarës, ku është burimi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Leonard Miloti – E kemi të hartuar në dhjetor të vitit të kaluar. Është 600 litra në sekondë. Nga këto burim ne do të marrim vetëm 137 litra në sekondë. Është më se e mjaftueshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

600, në periudhën më të thatë, në shtatorin e vitit të kaluar. Është përgatitur fizibiliteti dhe është bërë studimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne marrim çerekun.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë bëhet matja, në periudhën më të thatë.

Niko Peleshi – Ka ndonjë pyetje tjetër apo ndonjë diskutim? Para se ta hedh në votë, kam unë nga dy fjalë vlerësimi për bashkëpunimin e deritanishëm me Republikën e Gjermanisë. Nëpër vite kemi punuar me shumë donatorë, por besoj se ajo që e veçon dhe e dallon KfW-në dhe programet gjermane në përgjithësi, është fakti se i kopsitin investimet jo vetëm në pjesën e harduerit, por edhe të softuerit. Për këtë arsye, shpeshherë, ose pothuajse gjithmonë, projektet e realizuara me KfW-në shkojnë deri në fund dhe janë funksionale. Me këtë institucion, me këtë partner financiar nuk kemi raste që një investim të ketë përfunduar fizikisht, por praktikisht të mos funksionojë për shkak se mungon lidhja me rrjetin, se nuk

është zgjidhur mënyra e menaxhimit e të tjera. me KfW-në kemi mësuar se investohet shumë për të përcaktuar këtë pjesën e softuerit, pra për të zgjidhur softuerin, menaxhimin, ngritjen e kapaciteteve institucionale, e më pas të vazhdohet me investimet fizike. Besoj se ky është edhe çelësi i suksesit të investimeve të realizuara me këtë partner. Këtë e them edhe bazuar te eksperiencia ime personale.

Pas këtij vlerësimi, ju ftoj që ta votojmë.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2018 për projektin “Programi sektorial i ujërave/furnizimi me ujë i zonave rurale IV”?

Kundër? Abstenim? S’ka kundër, s’ka abstenim. Të gjithë janë dakord.

Miratohet!

Kalojmë në miratimin nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1? Kundër? S’ka kundër. Abstenim? S’ka abstenim.

Miratohet!

Kush është dakord me nenin 2? Kundër? S’ka kundër. Abstenim? S’ka abstenim.

Miratohet!

E hedhim në votë në tërësi.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? S’ka kundër. Abstenim? S’ka abstenim.

Miratohet!

Faleminderit!

E mbyllim mbledhjen.

Në lidhje me mbledhjen e radhës do të njoftoheni.

MBYLLET MBLEDHJA